Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e ILD për vitin 2025 masat, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse, treguesit bazë dhe objektivat e synuar						
Nr.	**REKOMANDIMI**	**MASA**	**AFATI**	**Struktura përgjegjëse**	**Objektivat e synuar**	**Shënime**
1	Të vijojë zhvillimin e kapaciteteve institucionale, administrative, teknike dhe njerëzore, në funksion të ushtrimit efektiv, cilësor dhe në kohë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të institucionit	1. Vlerësimi i nevojave për forcimin e kapaciteteve 2. Paraqitja e kërkesave tek partnerët ndërkombëtarë (projektet e asistencës, Këshilli i Evropës) 3. Plotësimin e vakancave përmes zhvillimit të procedurës së rekrutimit për inspektorë jomagjistratë, sipas kërkesave ligjore. 4. Ripërcjellja e kërkesës pranë KLGJ për komandimin e magjistratëve.	Shtator - Dhjetor 2026	ILD/KEV	Forcimi i kapaciteteve institucionale Plotësimi i vakancave	Në proces zbatimi
2	Të zhvillojë më tej sistemin e matjes së performancës institucionale, nëpërmjet përcaktimit dhe publikimit të treguesve objektivë të performancës, përfshirë kohën mesatare të shqyrtimit të ankesave, normën e përfundimit të procedimeve, nivelin e reduktimit të stokut të çështjeve të trashëguara dhe efektivitetin e rekomandimeve e masave të ndërmarra.	a. Raportimi periodik i ankesave në proces të deleguara te secili inspektor b. Monitorim të ecurisë së shqyrtimit të ankesave në proces c. Vlerësimi i rezultateve të arritura nga monitorimi, bazuar në: i.kohën mesatare të shqyrtimit të ankesave, ii. nivelin e reduktimit të ankesave të mbartura iii. publikimi dhe monitorimi i rezultateve.	Shtator - Dhjetor 2026	Administrata ILD	Përmirësimi në mënyrë të vazhdueshme të treguesve te performancës Ndjekjen dhe monitorimin e kohës së shqyrtimit të ankesave me synim reduktimin e ankesave të mbartura, duke publikuar të dhënat në	Në proces zbatimi

3	Të konsolidojë metodologjitë e inspektimit të bazuara në analizën e riskut dhe prioritizimin institucional, me synim identifikimin e hershëm të problematikave sistemike, përmirësimin e cilësisë së mbikëqyrjes dhe rritjen e efektivitetit të procedimeve disiplinore.	Vlerësimi i rezultateve/gjetjeve që do të konkludohen nga inspektimet vijuese. Analizim periodik i objektit të ankesave Shqyrtimi i propozimeve nga subjekte e posaçme për tematika inspektimi Analiza e raportimeve 6-mujore nga gjykatat për tematika inspektimi dhe verifikime kryesisht.	Dhjetor 2026	ILD	Përmirësimin e cilësisë së mbikëqyrjes dhe rritja e efektivitetit të procedimeve disiplinore	Në proces zbatimi
4	Të vijojë zhvillimin dhe funksionalizimin e sistemeve elektronike të administrimit të ankesave dhe proceseve institucionale, duke mundësuar gjurmueshmërinë në kohë reale të procedimeve dhe rritjen e ndërveprimit elektronik me institucionet e sistemit të drejtësisë, në funksion të rritjes së efikasitetit, transparencës dhe sigurisë juridike.	1. Në funksion të zhvillimit të sistemit elektronik për digjitalizimin e ILD-së , masat për t'u ndërmarrë janë: a. shpallja e procedurës së prokurimit b. lidhja e kontratës së zbatimit c. ndjekja e zbatimit të kontratës. d. vlerësimi për zhvillimin e nevojave të mëtejshme	Shtator 2026 e në vijim sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në ligjin për prokurimin publik	Administrata ILD	Rritja e efikasistetit për sigurimin e informacionit në kohë reale për menaxhimin e trajtimin e dokumenteve dhe ankesave/çështjeve që depozitohen në ILD, bazuar në platforma dhe standarde të cilat ofrojnë mundësi integrimi me sistemin e integruar të menaxhimit të çështjeve në sistemin e drejtësisë. Rritja e transparencës lidhur me veprimtarinë e ILD-së, dhe reduktimi i kohës për shqyrtimin e	Me miratimin e projektit të sistemit të digjitalizimit të ILD-së, nga Bordi drejtues I QTI-së, do të shpallet procedura e prokurimit për zbatimin e projektit. Parashikohet që kjo procedurë të përfundojë brenda vitit 2026. Në vijim të procedurës së prokurimit do të vijojë zbatimi i kontratës për zhvillimin e sistemit. Afatet dhe procedurat do të jenë objekt vlerësimi, në varësi të lidhjes së kontratës. Në përfundim të lidhjes së kontratës do të detajohen hapat vijues për gjurmueshmërinë në kohë reale të procedimeve. Në proces zbatimi

5	Të forcojë kapacitetet analitike dhe statistikore të institucionit, si dhe të publikojë periodikisht raporte analitike mbi trendet e ankesave, problematikat me karakter sistemik, praktikën disiplinore dhe ndikimin e masave të ndërmarra, me qëllim mbështetjen e funksionit parandalues dhe promovimin e një praktike të qëndrueshme.	1. Publikimi i raporteve tre mujore, për: a. trendet e pretendimeve të ankesave b. problematikat me karakter sistemik c. shkaqet e iniciimit të procedimit disiplinor dhe rezultatet (masat që kanë vendosur Këshillat) 2. Kërkesë për bashkëpunmi me INSTAT për përmirësimin e dhe grumbullimin e treguesve statistikore dhe analizat statistikore.	30 shtator 2026 31.12.2026	Administrata ILD	Rritja e transparences, mbi praktikat disiplinore te ILD	Për këtë masë do të publikohen raportet 3 mujore të: - pretendimeve të ankuesve - problematika të karakterit sistemik, të dala nga inspektimet - notat informative mbi shkaqet e kërkesës për procedim - rezultatet e shqyrtimit të tyre në Këshilla Në proces zbatimi
6	Të vijojë forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Shkollën e Magjistraturës dhe institucionet e tjera relevante, në funksion të identifikimit të problematikave sistemike, shkëmbimit të praktikave më të mira dhe koordinimit të masave parandaluese. Gjithashtu të finalizojë protokollin e bashkëpunimit ndërinstitucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme lidhur me aksesin në sistemet elektronike të gjykatave dhe prokurorive	1. Pjesëmarrja dhe kontributi në Mbledhjet e Përbashkëta të Këshillave për të adresuar problematika të karakterit sistemik që afektojnë sistemin, ushtrimin e funksioneve dhe që kërkojnë koordinim institucional. 2. Zhvillimi i takimeve me KLGJ/KLP/PP për adresimin e tematikave apo problematikave të sistemit të cilat mund të adresohen përmes inspektimeve tematike. 3. Inicimi i një memorandumi bashkëpunimi lidhur me aksesin në sistemet elektronike me KLGJ/KLP/PP	1. të paktën 2 herë në vit, dhe rast pas rasti 2. Dhjetor 2026 3. Nëntor 2026	ILD	Rritja e bashkëpunimit me organet e sistemit të drejtësisë, për adresimin e problematikave sistemike të sistemit, në përputhje me kompetencat ligjore, me synim parandalimin dhe reduktimin e tyre	Në proces zbatimi
7	Të zhvillojë më tej analizën e praktikës disiplinore, me synim garantimin e një praktike të qëndrueshme, të unifikuar dhe të parashikueshme, në përputhje me parimin e sigurisë juridike dhe standardet e shtetit të së drejtës	1. Vijimin e analizave rast pas rasti kur qëndrimet e Këshillave ndryshojnë duke evidentuar shkaqet dhe analizën ligjore të Këshillit përkatës dhe vlerësimin e ushtrim të diskrecionit nga Këshilli. 2. Analiza ligjore e vendimmarrjeve eventuale të GJK/GJEDNJ dhe reflektimi i tyre në procedimet vijuese.	Dhjetor 2026 dhe në vijim	Administrata ILD	Konsolidimi i mëtejshëm i praktikës disiplinore në përputhje me standartet me të mira ndërkombëtare	Në proces zbatimi

8	Të vijojë zhvillimin e veprimtarisë ndërgjegjësuese dhe komunikimit institucional me publikun, si dhe të rrisë transparencën institucionale nëpërmjet publikimit periodik të statistikave të detajuara dhe vendimeve të përmbledhura, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale	1. Pasurimi i rubrikave në faqen zyrtare të institucionit me funksion rritjen e ndërgjegjësimit për veprimtarinë e ILD-së . 2. Zhvillimi i vizitave në funksion të edukimit ligjor në ambinetet e ILD dhe në rrethe. 3. Publikimi i raporteve të përmbledhura tematike të hetimit disiplinor të anonimizuara për çështje me interes publik, në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe mirëadministrimit të drejtësisë.	Shtator - Dhjetor 2026	Administrata ILD	Rritja e transparencës dhe edukimit ligjor të publikut	Në proces zbatimi
9	Të vijojë harmonizimin e praktikës institucionale me standardet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe organizmave ndërkombëtarë në fushën e pavarësisë, përgjegjshmërisë, integritetit dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë.	1. Analizimi i dokumenteve ndërkombëtare (Progres Raporti; Raporti i Shtetit të së drejtës etj) duke evidentuar gjetjet dhe rekomandimet për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe në varësi të natyrës së rekomandimit, marrja e masave për adresimin e tyre dhe monitorimi përkatës i këtyre masave. 2. Paraqitja e kërkesës për asistencë teknike nga projektet e asitencës (Delegacioni i BE, Këshilli i Europës)	Në varësi të afateve të lëna nga institucionet koordinuese (MD) Tetor 2026	Administrata ILD	Konsolidimi i mëtejshëm i praktikës disiplinore në përputhje me standartet me të mira ndërkombëtare	Në proces zbatimi
10	Në raportin vjetor të paraqitur Kuvendit, krahas të dhënave statistikore, të përfshijë analiza mbi problematikat strukturore, tendencat e veprimtarisë, efektivitetin e masave të ndërmarra, si dhe, kur është e nevojshme, propozime konkrete për përmirësime ligjore, institucionale ose administrative, në funksion të forcimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit	1. Zhvillimi i mëtejshëm i analizave për problematikat strukturore. 2. Vlerësimin e përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga inspektimet. 3. Paraqitja sipas rastit të nevojave për ndryshime ligjore organeve kompetente sipas fushës së përgjegjësisë.	Dhjetor - 2026 e në vijim	Administrata ILD	Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe rritja e besimit të publikut	Në proces zbatimi

11	Të ndërmarrë një rol më aktiv, përfshirë nëpërmjet iniciativës lidhur me çështjet me natyrë disiplinore, bazuar në të dhëna dhe fakte publike. Për kërkesat për procedim disiplinor, të raportojë periodikisht mbi vendimmarrjen e Këshillave dhe problematikat e evidentuara	1. Vijimin e marrjes së masave për monitorimin, evidentimin dhe analizimin e fakteve/të dhënave publike (media e shkruar dhe audiovizive) të cilat mund të shërbejnë si bazë për fillimin e verifikimit/hetimit me iniciativë të ILD-së. 2. Raportim periodik pranë Kuvendit. Masat e marra për publikimin e procedimit disiplinore dhe këshillave janë parashikuar për masat lidhur me rekomandimin nr.8	Shtator 2026 Dhjetor 2026 e në vijim	Administrata ILD	Konsolidimi i mëtejshëm i praktikës disiplinore.	Në proces zbatimi
12	Të hartojë një matricë të standardizuar me të dhëna mbi rekomandimet e dhëna, institucionin përgjegjës, afatet, statusin dhe evidencën e zbatimit, si dhe rezultatin e arritur.	Publikimi i matricës me të dhënat sipas urdhrit nr. 147 datë 31.12.2025 të ILD-së për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve sipas institucioneve përgjegjëse.	Shtator 2026	Administrata	Konsolidimi i mëtejshëm i metodologjisë inspektuese.	Në proces zbatimi
13	Në përputhje me rekomandimet e BE-së, të trajtojë me prioritet rastet që lidhen me korrupsionin në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë, duke hartuar një plan koordinimi me institucionet përgjegjëse për ndjekjen e tyre	1. Diskutim në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve për hapat qe dotë ndërmerren në kuadër të planit koordinues me organet kompetente për rastet që lidhen me korrupsionin në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë, për refererimin e rasteve të shkeljeve të natyrës disiplinore	Shtator - Dhjetor 2026	Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve /ILD	Forcimi i bashkepunimit dhe kordinimit me institucionet përgjegjëse për të parandaluar rastet e korrupsionit në sistemin e drejtësisë në përputhje me kompetencat ligjore	Në proces zbatimi

14	Të përfshijë në inspektimet prioritare performancën e prokurorëve lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, marrëdhënien profesionale me drejtuesit e prokurorive, si dhe me cilësinë e akteve hetimore të prodhuara nga OPGJ-të në funksion të procedimit penal.	Diskutim në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve për: 1. Mundësinë e një inspektimi vijues mbi zbatimin e rekomandimeve për raportin e inspektimit nr. 3409, datë 29.12.2022 "Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm". 2. Mundësinë e një inspektimi tematik/institucional për cilësinë e akteve të prodhura nga OPGJ-të në funksion të procedimit penal.	Shtator 2026 Dhjetor 2026	Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve	Përfshirja e në planin e inspektimeve të problematikave sistemike në sistemin e drejtësisë	Në proces zbatimi
15	Të ndërmarrë masa për reduktimin e kohëzgjatjes së verifikimit dhe shqyrtimit të ankesave, duke shmangur vonesat e paarsyeshme që ulin ndjeshëm efektivitetin e mekanizmit të verifikimit, si dhe të raportojë periodikisht mbi afatet e shqyrtimit, stokun e ankesave të mbartura dhe shkaqet e vonesave në trajtimin e tyre, duke vendosur standarde të brendshme për respektimin e afateve të arsyeshme dhe monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të tyre.	1. Diskutim në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspketorëve për rishikim i procedurave të brendshme për përshpejtimin dhe monitorimin e shqyrtimit të ankesave, me raportim periodik mbi afatet dhe vonesat, ku të parashikohet: a. kategorizimi b. prioritizimi c. afati i shqyrtimit të tyre d. raportimi periodik i trajtimit të tyre e. monitorimi i ecurisë së shqyrtimit	Shtator - Dhjetor 2026	Administrata/ Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorve/ ILD	Konsolidimi i mëtejshëm i praktikës disiplinore.	Hartimi i një projekturdhri pas vlerësimit dhe konluzionet e MPI-së. Në proces zbatimi

16	Të adresojë me efektivitet hendekun mes numrit shumë të lartë të ankesave të qytetarëve përkundrejt numrit shumë të ulët të procedimeve disiplinore, për të përmbushur cilësisht standardet e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë	1. Krijimi i një baze të dhënash që evidenton ankesa të përsëritura për të njëjtin magjistrat ose të njëjtën natyrë shkeljeje. 2. Publikimi i praktikës së ILD-së për rritjen dhe forcimin e edukimit ligjor të publikut për rastet që i japin shkas verifikimit/hetimit disiplinor. 3. Rritje e ndërgjegjësimit përmes veprimtarisë edukative të publikut në lidhje me rolin e ILD-së kur publiku shfaq mosdakordësi ndaj vendimeve gjyqësore ose veprimtarisë hetimore.	Shtator - Dhjetor 2026	Administrata ILD		Cilësia e standardeve të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, nuk mund të vlerësohet vetëm me indikatorë sasiorë, si mund të jetë diferenca ndërmjet numrit të lartë të ankesave dhe numrit të ulët të procedimeve disiplinore. Vlerësimi nëse në përfundim të hetimit do të vijohet me procedim disiplinor është diskrecion i ILD-së, bazuar në parashikimet kushtetuese dhe ligjore. Aktualisht Këshillat dhe KPA kanë konfirmuar standardet dhe prakikat e ndjekura gjatë zhvillimit të hetimeve disiplinore, duke evidentuar respektimin e të gjitha parimeve dhe procedurave ligjore. Në proces zbatimi
17	Të marrë masa për të përmirësuar cilësinë dhe arsyetimin e përgjigjeve institucionale ndaj ankesave, duke shmangur komunikimet formale ose adresime jo të plota të pretendimeve të ngritura, me qëllim rritjen e besimit të publikut në veprimtarinë e institucionit.	Diskutim në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve për masat administrative të mundshme	Dhjetor 2026	ILD/MPI/ Kabineti		Vendimmarrjet e arkivimit pas shqyrtimit fillestar/pas verifikimit apo mbylljet e hetimit të cilat janë bërë objekt ankimi në Këshillat përkatës nuk janë cenuar për problermatika në arsyetim apo kryerjene e verifikimeve/hetimeve të mëtejshme.

18	Të miratojë dhe zbatojë një metodologji të unifikuar për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore, në funksion të forcimit të kapaciteteve analitike dhe statistikore të institucioni	1.Përfshirja në termat e referencës së dokumentacionit standard të tenderit, të moduleve të cilat do të garantojnë, për veç të tjerave: -mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore, në funksion të forcimit të kapaciteteve analitike dhe statistikore të institucioni, sipas akteve të brendshme të miratuara.	Dhjetor 2026 e në vijim		Forcimi i kapaciteteve analitike dhe perpunimit statistikor	Në proces zbatimi

19	Të formulojë dhe paraqesë propozime për ndërhyrje të nevojshme ligjore lidhur me përmbushjen e detyrimit për të plotësuar vakancat në institucion	Ridërgimi i propozimeve për ndryshime ligjore sipas mendimit të shprehur nga ILD me shkresën nr. 3636/1 datë 09.01.2026	Dhjetor 2026	Administrata ILD	Plotësimi i vakancave dhe rritja e efikasitetit të veprimtarisë institucionale.	Përsëritja e kërkesës për propozime ligjore lidhur me garancitë për ecurinë në karrierë duke i caktuar magjistratët e komanduar në ILD, në nivel apeli pa iu nënshtruar procesit të ngritjes në detyrë. Caktimi në nivel apeli, duhet të ketë si parakusht që përveç plotësimit të kritereve ligjore për ngritjen në detyrë, të ketë edhe vlerësimin etiko-profesional në nivelin "shumë mirë", të vlerësuar nga ILD pas mbarimit të mandatit të komandimit. Caktimi i gjyqtarit/prokurorit në nivel apeli në fund të mandatit të komandimit në ILD, pa iu nënshtruar procesit të ngritjes në detyrë. Duke qenë se ligji aktualisht parashikon që komandimi i magjistratëve në ILD konsiderohet ngritje në detyrë, Këshillat duhet t'i japin përparësi magjistratit të komanduar, duke caktuar magjistratët e shkallës së parë që përfundojnë periudhën e komandimit në gjykatat e apelit, në respektim të përcaktimeve të bëra në nenin 55, pika 6 të ligjit të statusit. Në proces zbatimi

20	Të forcojë dialogun dhe bashkëpunimin ndërinstitucional lidhur me inspektimet tematike, si dhe në funksion të adresimit të rekomandimeve dhe të sfidave sistemike. Të forcojë dhe institucionalizojë dialogun dhe konsultimet me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e drejtësisë dhe të të drejtave të njeriut, në funksion të të përmirësimit të veprimit institucional	Tryeza konsultuese me organet e qeverisjes dhe MD në lidhje me çështjet me natyrë sistemike të evidentuara nga këto organe në përmbushje të veprimtarisë institucionale. Riparaqitje e kërkesave Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë Tryeza konsultimi me organizatat e Shoqërisë Civile me të cilat ILD ka marrëveshje bashkpunimi mbi monitorimin dhe analizimin e veprimtarisë së ILD-së	Nëntor 2026 Dhjetor 2026	ILD	Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit institucional	Në proces zbatimi
21	Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për shkëmbimin e informacionit për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare, brenda tremujorit të tretë të vitit 2026	1. Vënia në dispozicion e koordinatorit dhe të dhënave përkatëse të kontaktit. 2.Bashkëpunimi sipas kërkesave me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës.	Shtator - Dhjetor 2026	Administrata ILD	Rritja e bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë	Realizuar, përcjellë Kuvendit më datë 9.10.2026.
22	Brenda 30 ditësh nga miratimi i rezolutës, të hartojë dhe publikojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, i cili të përcaktojë masat konkrete, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse, treguesit bazë dhe objektivat e synuar, si dhe të raportojë periodikisht mbi nivelin e përmbushjes së tyre	1. Hartimi dhe publikimi i një plani të detajuar veprimi për zbatimin dhe monitorimin e rekomandimeve	Shtator 2026	Administrata ILD	Rritja e bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë	Realizuar, përcjellë Kuvendit më datë 31.08.2026.